



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal Nr. 4
nga mbledhja e mbajtur më **27.3.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

- | | |
|-----------------|-------------------------|
| 1. Lulzim | Zeneli |
| 2. Ibrahim | Selmanaj |
| 3. Zylfi | Merxha |
| 4. Berat | Luzha |
| 5. Elheme | Hetemi |
| 6. Zef | Morina |
| 7. Heset | Cakolli |
| 8. Selvie | Halimi |
| 9. Myrvete | Pantina |
| 10. Kosara | Nikolić |
| Mungoi : | |
| 11. Ali | Lajçi (me arsye) |

**PJESËMARRËSIT TJERË : Nazmi Shkodra dhe Muhamet Malësiu si dhe
vëzhgues nga presidenca dhe mediat**

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Amendamenti i Komisionit për Buxhet në p/1 për kooperativat e bujqve.
3. Projektligji për Mbrojtjen e Mjedisit.

1. Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua me një vërejtje nga **Elheme Hetemi** lidhur me fjalën “Statusi” i cili në këtë rast për të cilën është përmend duhet të shënohet “Statuti”.

2. Amendamenti i Komisionit për Buxhet lidhur me projektligjin për kooperativat e bujqve “ **Mjetet e realizuara nga pagesa e dënimeve për shkelje të dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.**” u miratua me vërejtjen e komisionit që fjala “Konsoliduar” të mos figuroi në këtë amendament, për shkak se Kosova pasi që fitoi pavarësinë nuk do të ketë nevojë për këtë fjalë sa i përket buxhetit. **Zef Morina** përkrahu iniciativën e **Shefki Zeqirit (MBPZHR)** për të hequr këtë fjalë, ndërsa **Myrvete Pantina** tha se në komisionin për buxhet nuk është diskutuar për këtë fjalë.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit filloi me ndërhyrjen e **Selvie Halimit** e cila kërkoi prezencën e Ministrit të MMPH për këtë projektligj ashtu si është marr vesh komisioni me të në takimin e dt. 18.3.2008. Shkaku pse duhet të prezantoi ministri, sipas saj është se ai duhet ti sqaroi komisionit që ky ligj , përkatësisht AKMM-ja a do të ketë në kuadrin e vet Agjencionin e efqencës së energjisë, si dhe disa çështje tjera sekondare të cilat duhet të rregullohen me akte nënligjore. Pasi që zyrtarët nga MMPH nuk kishin informatë lidhur me këtë kërkesë, ajo propozoi që mbledhja të shtyhet lidhur me këtë pikë dhe të ftohet ministri për mbledhjen e radhës.

Lulzim Zeneli vazhdoi kryesimin e mbledhjes duke i pyetur të pranishmit për ndonjë çështje tjetër parimore lidhur me këtë projekt, me ç’rast **Zef Morina** përkrahu **Selvie Halimin** për shtyerje të mbledhjes dhe të ftohet ministri personalisht për mbledhjen e radhës, me të cilin konkludim (kërkesë) edhe përfundoi shqyrtimi i kësaj pike.

Të ndryshme

Lulzim Zeneli rikujtoi anëtarët e komisionit se për seancën e nesërme plenare janë paraparë leximi i dy projektligjeve në parim të cilat i takojnë fushëveprimtarisë së këtij komisioni. Pasi që është bërë njoftimi preliminar edhe nga ana e koordinatorit të komisionit, ai ftoi nëse ka propozime për të marr ndonjë qëndrim komisioni lidhur me leximin e parë të këtyre dy projekteve. Komisioni nuk nxori qëndrimin e përbashkët por u pajtua që secili anëtarë i komisionit mund të dalë me qëndrimin personal për këto dy projektligje , sikurse edhe çdo deputet tjetër.

Në pyetjen e **Zef Morinës, kryesuesi** u përgjigj se monitorimi i ndonjë ligji që i përket fushës së këtij komisioni do të bëhet sipas planit të punës së komisionit dhe propozoi që kjo të jetë pika e dytë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

U vendos që mbledhja e radhës të mbahet të martën në orën 13,00

Takimi përfundoi në orën 11,40

Bajram Badivuku zyrtar i lartë ligjor

Kryesuesi i Komisionit-kryetari,

Lulzim Zeneli

